



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL
DREJTORIA E LEGJISLACIONIT DHE SIGURISË NË OPERIM

Nr. 261/prot.

Tiranë, më 26.01.2026

VENDIM

Nr. 15, datë 26.01.2026

PËR

**MIRATIMIN E “UDHËZUESIT MBI HAPAT PËR REGJISTRIMIN E
OPERATORËVE TË DRONËVE NË SHQIPËRI”**

Në mbështetje të pikës “ë”, të nenit 14, të Ligjit Nr.53/2022 “Për organizimin dhe funksionimin e Autoritetit të Aviacionit Civil”:

V E N D O S A

1. Miratimin e ACAA-DFS-GM15-UASID “Udhëzues mbi Hapat për Regjistrimin e Operatorëve të Dronëve në Shqipëri”, Lëshimi 02, Rishikimi 00.
2. Ngarkohet Drejtoria e Standardeve të Fluturimit, të sigurojë shpërndarjen dhe përdorimin e këtij materiali tek operatorët.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR EKZEKUTIV

Maksim Et’hemaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË



AUTORITETI I AVIACIONIT CIVIL SHQIPTAR

UDHËZUES MBI HAPAT PËR REGJISTRIMIN E OPERATORËVE TË DRONËVE NË SHQIPËRI

ACAA- DFS-GM15-UASID
Lëshimi: 02, Rishikimi 00
Datë: 26.01.2026

Miratur nga:

Maksim Et'hemaj

Drejtor Ekzekutiv I Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar





0. ADMINISTRIMI

Përmbajtja

0. ADMINISTRIMI.....	2
0.1 Regjistri i Rishikimeve	3
0.2 Lista e Miratimeve	3
0.3 Tabela e Rishikimit.....	4
0.4 Lista e Shpërndarjes	4
0.5 Përkufizime	4
1. Hapat për Regjistrimin e Operatorëve të Dronëve në Shqipëri	5
1.1 Kush duhet të regjistrohet si operator?	5
1.2. Hapat për Regjistrimin si operator.....	5
2. Mënyrat e dërgimit të aplikimit.....	7
3. Lëshimi i ID-së dhe Certifikatës së Operatorit	7
4. Rinovimi i ID së Operatorit	8
4. Kujdes:.....	8



0.3 Tabela e Rishikimit

Faqe #	Nr.Lëshimit	Nr.Rishikimit	Data	Modifikuar nga
All	02	00		

0.4 Lista e Shpërndarjes

Kontrolli #	Personi përgjegjës	Tipi i dokumentit
Originali	SAVS/DFS SSS/DAM	Kopje Fizike
Originali (Elektronik)	Stafi i SAVS	Kopje Elektronike në DRMS

Shënim: Në rast të një pale të interesuar të përfshirë në aktivitetet e ACAA-së, të drejtat e aksesit do të jepen rast pas rasti nga Drejtoria/Spektori përkatës.

0.5 Përkufizime

Për qëllimin e këtij manuali udhëzues, termat e mëposhtëm nënkuptojnë:

“Sistemi i avionit pa pilot” (UAS) (unmanned aircraft system), është një avion pa pilot dhe pajisjet për ta kontrolluar atë në distancë;

“Operatori i sistemit të avionit pa pilot” (operatori i ‘UAS’) është çdo person juridik ose person fizik që operon ose ka për qëllim të operojë një ose më shumë UAS;

“Sistemi i avionit pa pilot” (UAS) (unmanned aircraft system), është një avion pa pilot dhe pajisjet për ta kontrolluar atë në distancë;



1. Hapat për Regjistrimin e Operatorëve të Dronëve në Shqipëri

1.1 Kush duhet të regjistrohet si operator?

Sipas **Urdhrit të Ministrit Nr. 143, datë 18.07.2022**, të gjithë operatorët e dronëve janë të detyruar të regjistrohen, me përjashtim të atyre që:

- Pesha është më pak se **250g**, janë lodra, dhe nuk kanë sensorë për mbledhjen e të dhënave personale (kamerë, mikrofon, etj).

Pesha e dronit	Kërkohet regjistrimi?
<250g (lodër)	Jo
<250g, pa sensor për mbledhjen e të dhënave	Jo
<250g, me sensor për mbledhjen e të dhënave	Po
≥250g	Po

Bazuar në Nenin 14 të Urdhrit të Ministrit 143 datë: 18.07.2022 për UAS:

“Operatorët e UAS-së duhet të regjistrojnë vetveten në AAC, kur RSH-ja është vendbanimi i tyre për persona fizikë ose kur RSH-ja është vendi i tyre kryesor i biznesit për personat juridikë dhe të sigurojnë që informacioni i tyre për regjistrimin të jetë i saktë. Një operator UAS-je nuk mund të regjistrohet në më shumë se një shtet njëkohësisht.”

Kjo do të thotë se **vetëm rezidentët shqiptarë dhe bizneset që ushtrojnë aktivitet në Shqipëri** kanë të drejtë të regjistrohen si operatorë.

1.2. Hapat për Regjistrimin si operator

HAPI 1 – Shkarkoni dhe Plotësoni Formular përkatës.

Shkarkoni formën e aplikimit përkatëse:

- **ACAA-DFS-UASM-100** – për Persona Fizikë
- **ACAA-DFS-UASM-129**¹ – për Persona Juridikë

Zgjidhni:

- ☐ Aplikim Fillestar (Nëse aplikimi bëhet nga fillimi)
- ☐ Rinovim (Nëse certifikata është afër skadencës ose ka skaduar)
- ☐ Ndryshim të të dhënave ekzistuese (Nëse ndonjë nga të dhënat tuaja ka ndryshuar)

Formulari mund të plotësohet elektronikisht në word dhe duhet të jetë i nënshkruar:

- nga vetë aplikuesi (persona fizikë) kur plotësohet forma ACAA-DFS-UASM-100

¹ Forma e aplikimit, në secilin rast, duhet të jetë e nënshkruar nga aplikanti. Nëse forma e aplikimit nuk është e nënshkruar dhe mungon dokumentacioni i kërkuar sipas formës së aplikimit përkatëse, **aplikimi do të refuzohet**.

- nga administratori apo personi i autorizuar (persona juridikë) kur plotësohet forma ACAA-DFS-UASM-129

HAPI 2 – Përgatitja e Dokumenteve

Për Persona Fizikë:

- a. Formulari i plotësuar ACAA-DFS-UASM-100
- b. Kopje e skanuar e kartës ID ose pasaportës.
- c. Numri, numri serial dhe specifikimet teknike për secilën UAS në përdorim dhe plotësimi i tabelës në formën ACAA-DFS-UASM-100.
- d. Informacion mbi policën e sigurimit (kur kërkohet nga rregullorja)

Për Persona Juridikë (bizneset, shoqëritë):

- a) Formulari i plotësuar ACAA-DFS-UASM-129
- b) Kopje e skanuar e kartës ID ose pasaportës të punonjësit ose përfaqësuesit të autorizuar.
- c) Numri, numri serial dhe specifikimet teknike për secilin UAS në përdorim dhe plotësimi i tabelës në formën ACAA-DFS-UASM-129.
- d) Informacion mbi policën e sigurimit (kur kërkohet nga rregullorja)
- e) Prokura për përfaqësuesin e autorizuar (kur aplikimi nuk bëhet nga administratori i shoqërisë), ose
- f) Vërtetim për punonjësën (nëse aplikimi bëhet nga një punonjës i autorizuar nga kompania së bashku me autorizimin)
- g) Kopje e regjistrimit të biznesit nga QKB

HAPI 3 – Plotësoni të Dhënat Themelore në Formë (Sipas Kategorisë)

a. Për Persona Fizikë (Individë)

Në formularin **ACAA-DFS-UASM-100**, plotësoni:

- Emër dhe mbiemër të aplikantit
- Numri personal i identifikimit (ID ose pasaportë)
- Adresa e banimit
- Data e lindjes
- Shtetësia
- Numri i kontaktit dhe e-maili personal
- Lloji i operimit (rekreativ / profesional)
- Deklaratë që do të vendosni ID-në e operatorit në çdo dron që zotëroni
- Numri dhe data e skadencës së policës së sigurimit (nëse është e aplikueshme)

b. B. Për Persona Juridikë (Kompani, Shoqëri, etj)

Në formularin ACAA-DFS-UASM-129, aplikanti duhet të plotësojë:

- Emrin e kompanisë ose subjektit
- NUIS (NIPT) të subjektit
- Adresën zyrtare të kompanisë
- E-mail zyrtar dhe numër kontakti

- Emrin, mbiemrin dhe ID e përfaqësuesit të autorizuar (Administratorit ose punonjësit të autorizuar)
- Në rastin kur përfaqësuesi i autorizuar nuk është administratori por një punonjës i autorizuar, duhet të bashkëngjitet vërtetim që punonjësi është i punësuar në atë kompani dhe një autorizim për të kryer aplikimin.
- Adresën dhe e-mailin e përfaqësuesit të autorizuar (Administratorit)
- Shtetësinë e përfaqësuesit
- Numri dhe data e skadencës së policës së sigurimit (nëse aplikohet)

Deklaroni gjithashtu:

- Që dokumentacioni është i vërtetë dhe i vlefshëm
- Që personeli i përfshirë në operim është i kualifikuar
- Që ID-ja e operatorit do të vendoset në çdo dron në përdorim
-

Shënim

Regjistrimi si operator i UAS-së i nënshtrohet një tarife, në përputhje me Udhëzimin e Përbashkët Nr. 11, datë 24.12.2024 "Për tarifat që zbatohen nga Autoriteti i Aviacionit Civil" Kapitulli V pika (1).

2. Mënyrat e dërgimit të aplikimit

Aplikimi mund të dërgohet elektronicisht nëpërmjet adresës e-mail dron@acaa.gov.al, si edhe me postë në adresën:

Autoriteti i Aviacionit Civil Shqiptar

Rr. "Sulejman Delvina", Nr.1, P.O Box 205, Tiranë

Tel: +355 422512220

3. Lëshimi i ID-së dhe Certifikatës së Operatorit

Pas shqyrtimit të aplikimit:

Në rast pranimit:

Aplikuesi do të pajiset me një ID Operatori UAS (p.sh. ALBxxxxxxxxxxx-xyz) dhe do të lëshohet Certifikata e Operatorit, në përputhje me kërkesat përkatëse ligjore dhe teknike.

Certifikata e re do të ketë një vlefshmëri 3 vjecare dhe do të jetë subjekt rinovimi.

Në rast refuzimi:

Aplikuesi do të njoftohet zyrtarisht, duke u informuar mbi arsyet e refuzimit të aplikimit.

4. Rinovimi i ID së Operatorit

Qëllimi i Rinovimit

Procesi i rinovimit siguron vazhdimësinë e autorizimit për operatorët ekzistues pa nevojën e ri-regjistrimit. Operatori ruan të njëjtin ID Operatori dhe numër regjistri, ndërsa përditësohet periudha e vlefshmërisë dhe numri i rishikimit.

Kush mund të aplikojë për rinovim

Ky proces zbatohet për të gjithë operatorët (persona fizikë dhe juridikë) që kanë një certifikatë aktive ose të skaduar dhe dëshirojnë të vazhdojnë të mbajnë ID e Operatorit aktive.

Kushtet për Rinovim

Rinovimi mund të kryhet vetëm nëse:

- Aplikimi është i plotë.
- Të dhënat janë të sakta dhe të përditësuara.
- Plotësohen kërkesat e kompetencës dhe përputhshmërisë.
- Certifikata nuk është revokuar ose pezulluar.

Procedura e Rinovimit

- Ndiquen të njëjtat hapa si në **aplikimin fillestar**.
- Dokumentet ende të vlefshme mund të ripërdoren.
- Dokumentet e skaduar duhet të ri-ngarkohen.
- Në formular përzgjidhet opsioni **Rinovim**.

Pas Rinovimit

- Ruhet e njëjta ID Operatori.
- Lëshohet certifikatë e re me afat 3-vjeçar.
- Vendoset numër i ri rishikimi.
- Referohet certifikata e mëparshme.

Detyrimet e Operatorit

- Të aplikojë në kohë për rinovim.
- Të mbajë të përditësuara të gjitha të dhënat.
- Të njoftojë ACAA për çdo ndryshim sipas kushteve ligjore dhe deklaratave të firmosura nga aplikanti.

4. . Kujdes:

- Të dhënat ruhen bazuar në ligjin Nr. 124/2024, datë 19.12.2024 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"
- Tre shifrat e fundit të ID-së janë **sekrete** – mos i ndani me të tretët!

- Regjistrimi si operator UAS ju pajis me një ID unike operatori, e cila shërben për t'ju identifikuar ju si person fizik / subjekt përgjegjës për operimin e dronëve. Kjo ID nuk përfaqëson regjistrimin individual të dronit, por lidhet drejtpërdrejt me operatorin.
- Sipas detyrimeve ligjore në fuqi, ju jeni përgjegjës për vendosjen e kësaj ID-je në çdo dron që zotëroni apo operoni. "Pajisja me ID Operatori nuk përbën autorizim për të operuar dronë me peshë mbi 250 gram. Për të kryer fluturime me dronë që kalojnë këtë prag peshe, operatori ose çdo person që do të përdorë dronin duhet të jetë i pajisur me një Certifikatë të Pilotit në Distançë, në përputhje me kategorinë e operimit përkatëse, sipas rregulloreve në fuqi.
- Operator ID dhe Certifikata janë të vlefshme për 3 vjet nga data e lëshimit.
- ACAA mund të pezullojë ose revokojë certifikatën në rast:
 - Mosrespektimi të rregulloreve
 - Shkelje të kushteve të operimit
 - Dhënie e informacionit të rremë
 - Mungesë dokumentacioni të vlefshëm
- Në rast ndryshime të të dhënave tuaj që janë subjekt aprovimi paraprak duhet të njoftoni AAC paraprakisht sipas afateve të përcaktuara në formën e aplikimit, për të njoftuar këto ndryshime mund të përdoren format e aplikimit fillestar ku dhe përcaktohen ndryshimet ligjore për të cilat nevojitet aprovim paraprak nga AAC.